



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 30.03. 2018, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Fatmir Xhelili, Muharrem Nitaj, Xhelal Sveçla, Drita Millaku, Ismet Beqiri, Fadil Beka dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Mungoi: Ramiz Kelmendi

Deputetët të tjerë, pjesëmarrës në takim: Shemsi Syla, Nait Hasani

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Diskutim lidhur me situatën e sigurisë pas ngjarjes së datës 29.03.2018

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetari, fillimisht theksoi që kjo mbledhje urgjente është thirrur me rastin e depërtimit të gjashtë qytetarëve turq nga Kosova, gjithashtu theksoi se nga ana e institucioneve të Kosovës duhet të reagohet me përgjegjësi dhe të shikohet se nga kush është marrë vendimi për një veprim të tillë.

Rexhep Selimi, lidhur me rastin e depërtimit të qytetarëve turq, theksoi se një veprimi i tillë nga ana e institucioneve të Kosovës është i papranueshëm dhe i dëmshëm për vendin, gjithashtu theksoi se duhet të kërkohet raport nga ana e institucioneve kompetente, me theks nga Policia e Kosovës.

Xhelal Sveçla, lidhur me rastin e depërtimit të qytetarëve turq, theksoi se ku ekstradim ka qenë i pa ligjshëm, duke iu referuar mënyrës se si është bërë. Tutje theksoi që për këtë çështje duhet të ftohet edhe Ministri i Drejtësisë, që në rast se ka pasur njohuri me atë se çfarë ka ndodhur, të ftohet për raportim. Po ashtu theksoi se është e njëjta gjë edhe me Presidentin e vendit, ku ka deklaruar që nuk ka pasur informata, duke shtuar që duhet të jepen sqarime se ku fillon dhe përfundon linja urdhërdhënëse. Gjithashtu shtoi se, Komisioni duhet të veprojë urgjent për këtë çështje, pasi qasja e cila është bërë e degradon shoqërinë dhe është veprim i dëmshëm për vendin.

Rexhep Selimi, duke iu referuar diskutimeve në Komision theksoi se edhe Presidenti i Turqisë Erdogan, ka bërë qëndrimin e tij publik ku thekson: “ Së fundmi Agjencia jonë Kombëtare e Inteligjencës, në bashkëpunim me Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës, kapën gjashtë përfaqësues të FETO-s në Ballkan, i sollën dhe ia dorëzuan organeve policore. Ne kemi thënë se ata do të ikin, kurs e ne do ti ndjekim dhe ti sjellim këtu me lejen e Zotit..., “. Nga ky deklaram, kuptohet që Presidenti turk ka qenë i involvuar në këtë operacion mes dy shërbimeve sekrete, ndërsa Presidenti i Kosovës, deri tani po e mohon përfshirjen.

Zoran Mojsilović, lidhur me rastin e depërtimit të qytetarëve turq, theksoi se nga ana e Ministrisë së MPB-së, nuk është kërkuar përgjegjësi nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Nëse Ministri nuk ka përvojë të mjaftueshme, Komisioni duhet ti ofroj mbështetjen, pasi kjo nuk bëhet policia mund të përfshijë gjithë sistemin e sigurisë, pasi Drejtori i Policisë ka informacione për çështjet e sigurisë, pasi kjo mund të nënkuptohet që në Kosovë vepron organizatë që nuk jep përgjegjësi, prandaj mendoj që Drejtori i Policisë e ka pasur rolin kryesor në këtë situatë dhe në situatat e tjera që ndodhin në Kosovë. Gjithashtu theksoi se Ministri i MPB-së është nga sektori civil dhe në vazhdimësi ndërrohen, atëherë Drejtori i Policisë duhet të jap përgjegjësi.

Drita Millaku, për ngjarjen e ndodhur theksoi se është shqetësim i gjithë deputetëve, ndërsa ajo që e ka shqetësuar më shumë ka qenë mos pasja e informacionit nga ana e Kryeministrit. A e amnistion Kryeministrin, mos pasja e informacionit për rastin e depërtimit të qytetarëve turq? Tutje theksoi se një situatë e tillë është e pa natyrshme, pasi Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, është i përfshirë në këtë rast. Sa i përket lidhjes mes Presidentit të Turqisë dhe Presidentit të Kosovës, theksoi se kjo lidhje është shfaqur edhe më herët, pasi të dy kanë pasur informacione, duke kërkuar që të raporton të Komisionit Presidenti, pasi për këtë rast ka përgjegjësi edhe Kryeministri dhe mbase nuk e kontrollon situatën të jap edhe dorëheqje.

Muharrem Nitaj, për pyetjet drejtuar nga znj. Millaku, theksoi se duhen shtruar tek Kryeministri, duke shtuar që pavarësisht që Ministri i Punëve të Brendshme, ka pasur informacion nuk e ka transmetuar tek Kryeministri, dhe deklarimi i tij që nuk ka pas informacion ka qenë i sigurtë. Tutje theksoi se do të ishte mirë që të ftohen përfaqësuesit e institucioneve kompetente, në mënyrë që të krijohet përshtypja se çfarë ka ndodhur në të vërtetë, pasi ngjarja është e tillë që çdo qëndrim mund të qëndroj, prandaj e vlerësoi të nevojshme posedimin e informacionit zyrtar për të dhënë opinion.

Fatmir Xhelili, lidhur me diskutimet e bëra, theksoi se pajtohet që duhet të jenë më të informuar për këtë ngjarje, pasi nuk dihet akoma se çfarë rrezikshmërie kanë paraqitur qytetarët turq, kanë paraqitë rrezikshmëri për Kosovën apo për Turqinë. Për këtë rast, duhet të kuptohet që, a nuk kanë funksionuar hallkat e sistemit nga ana e detyrës zyrtare, informuese dhe vendimmarrëse, apo është metodë për të mos u sqaruar deri në fund, metodë që përdoret nga shërbimet inteligjente. Për këtë arsye, kërkoi që të përcaktohet se nga kush do të kërkohet informacion dhe raportim për këtë çështje, pasi duhet parë koordinimi mes institucioneve për marrjen e veprimeve, dhe të përcaktohen se kush duhet të ftohet.

Rexhep Selimi, duke iu referuar deklaramëve publike të Kryeministrit, theksoi se përgjegjësia kalon tek Ministri i Punëve të Brendshme, por nëse edhe ai nuk ka informacion atëherë është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, që është i lidhur drejtpërdrejtë me informacionin. Po ashtu theksoi që edhe Komisioni për AKI, duhet të kërkoj informacione lidhur me këtë ngjarje, duke shtuar që duhet të pritët edhe deklarimi i Ministrit të MPB-së, për të pasur informacione më të sakta. Gjithashtu theksoi se situata e tillë është e rëndë, duke kërkuar që të bëhet çfarë është e mundur nga ana e Komisionit.

Shemsi Sylja, lidhur me ngjarjen e ndodhur, theksoi se nuk janë të rastësishme, duke shtuar që Qeveria nuk është në dijeni se çfarë është duke ndodhur, duke shtuar se duhet të merret informacion edhe nga krerët e shtetit që kanë përgjegjësi.

Ismet Beqiri, lidhur me zhvillimet në vend, theksoi se nuk beson faktin që ka pasur deklarime nga ana e krerëve shtetëror që nuk kanë pasur informacione. Tutje theksoi se pajtohet që të kërkohet informacione nga institucionet kompetente, duke mos bërë deklarime politike për të përfituar në këtë rast.

Fatmir Xhelili, shtoi që, duke qenë se z. Haxhi Shala është anëtar i Komisionit për AKI, pas takimit që është planifikuar me zv. Drejtorin e AKI-së, mund të dilet me qëndrimin e Komisionit.

Xhelal Sveçla, propozoi që për këtë çështje të ftohen në Komision, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtorin e Operacioneve në kuadër të Policisë së Kosovës, Ministrin e Drejtësisë, ndërsa rrugë tjetër propozoi mbikëqyrjen e ligjit për të huaj.

Kryetari, me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala